


Zhvillohet webinar i për Inteligjencën Artificiale organizuar nga SAI i Suedisë

Në datë 5 mars u zhvillua online webinar i për Inteligjencën Artificiale, organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit Suedez, me pjesëmarrjen nga anëtarë të SAI-ve të ndryshëm, i cili u ndoq dhe nga tre auditues të Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Webinari kishte në fokus diskutimet mbi Inteligjencën Artificiale (AI) duke trajtuar përfitimet e rëndësishme për auditimin e sektorit publik - si efikasiteti i përmirësuar, saktësia e përmirësuar dhe aftësia për të analizuar shpejt grupe të dhënash të mëdha.

Gjithashtu, u diskutua dhe përdorimi i AI i cili vjen me risqe të mundshme, të tilla si paragjykimet në të dhëna, mundësia e keqpërdorimit ose abuzimit dhe nevoja për qeverisje të rreptë të të dhënave për të siguruar përdorim etik dhe të përgjegjshëm. Risqe të tilla mund të jenë veçanërisht të vështira për t'u trajtuar për SAI-t që punojnë në mjedise komplekse dhe sfiduese.



Pjesëmarrësit e webinarit duke shfrytëzuar elementët e plotë të platformës ZOOM mundën ti përgjigjeshin disa pyetësorëve (polls) virtualisht, mbi përdorimin e Inteligjencës Artificiale në punën audituese, si dhe drejtuan pyetje të ndryshme mbi përdorimin e AI, të cilat u trajtuan dhe u diskutuan nga 2 trajnuesit. Ata theksuan se ndërsa AI mund të rrisë efikasitetin dhe të zgjerojë fushën e analizës, ajo nuk mund të zëvendësojë gjykimin njerëzor në auditim.

Diskutimi përfundoi duke theksuar nevojën për zbatimin e kujdesshëm të AI në auditim, veçanërisht në mjediset ku kontrollet e cilësisë janë tashmë sfiduese.